



KONTRATE SHITJE PASURIE TE LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Sot me date 10.06 .2019 (dymije e nentembdhjete) ne Dhomen e Noterise Tirane, para meje Notere Arta Gj. Pjeter Nikaj, me seli ne adresen: Blv. "Zogu I", Rruga "Dervish Hatixhe", Tirane, u paraqiten personalisht palet kontraktuese:

**PALA SHITese Z. Albor Abedin Mulgeci**, lindur me 3.11.1996 ne Bajram Curri, Tropoje, banues ne Tirane, mbajtës i kartës së identitetit me me numër personal J61103021L, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, ortak ne shoqerine "FaH & Klo" shpk, regjistruar me NIPT L91408031L, me pjesemarrje ne perqindje ne kapital "100,00" .

**PALA BLERese Z. Basri Mexhit Hakcani**, lindur më 12.09.1985 në Tirane dhe banues në Tirane, mbajtës i kartës së identitetit me me numër personal I50912021E, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te letërnjoftimeve elektronike, ekstraktit te shoqerise dhe pasi konstatova se i kane te gjitha aftesite e ligjit, persona madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe per statusin aktiv te shoqerise me kerkesen e tyre si dhe duke u bazuar ne nenin 705 e vijues te Kodit Civil si dhe te ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Vendimi i Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, u redaktova kete Kontrate Shitje Pasurie te Luajtshme, Kuota Kapitali, si me poshte vijon:

"Pala Shitese e mesiperme deklarone se eshte zoterues i 1 (nje) kuote dhe ortake me pjesemarrje ne perqindje prej 100% të kapitalit te shoqerise "FaH & Klo" shpk, me kapital 1000 leke, shoqeri e regjistruar prane QKB me NIPT Nr. L91408031L me adrese ne Tirane, Farke, Sauk, Rruga "Xha Brahimet", Lagjia Sauk i Vjeter, Nd. 21.

Pala blerese eshte Z. Basri Hakcani, i cili deklarone se eshte plotesisht dakort qe te bleje kuotat e shoqerise "FaH & Klo" shpk. Pas marrjes se vendimit te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve Pala Shitese deklarone se i shet Pales Blerese 100% te kuotave te kapitalit qe ai zoterone ne shoqerine "FaH & Klo" shpk, konkretisht ne masen e pjesemarrjes ne perqindje prej 100% te kapitalit te shoqerise.

**Cmimi i shitjes se 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "FaH & Klo" shpk eshte 500 000 leke (peseqind mije leke) dhe palet deklarone se kane rene dakort qe pagesa e cmimit te shitjes se kuotave te kapitalit do te behet nepermjet bankes nga ana e pales blerese tek llogaria e pales shitese.**

Pala Blerese deklarone se pranon te bleje kuotat e kapitalit te specifikuar me siper dhe nuk ka asnje pretendim per kete shitje dhe behet zoterues i nje kuote dhe ortak i vetem me pjesemarrje 100% te kapitalit te shoqerise "FaH & Klo" shpk.

Pala Blerese me regjistrimin e vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per transferimin e kuotave ne QKB dhe depozitimimin e kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit njihet pronare e 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise:

-Z. Basri Hakcani behet ortak me 100% te kapitalit te shoqerise, zoterues i 1 (nje) kuote ne vleren prej 500.000, 00 lekesh (pese qind mije leke).

Palet bien dakord qe cdo te zbatojne te gjitha dispozitat ligjore perkatese per regjistrimin e ketij akti noterial ne te gjitha institucionet perkatese.

Une noterja vura ne djefti palet se regjistrimi i aktit noterial per pasqyrimin e ndryshimeve ne te gjitha institucionet perkatese duhet te behet brenda 30 diteve nga nenshkrimi i aktit, ne rast vonese ne perputhje me legjislacionin ne fuqi aplikohet penalitet per cdo dite vonese pas kalimit te ketij afati.

Palet deklarojne se kane rene dakort qe regjistrimin e akteve prane QKB do ta beje Z. Basri Hakcani ose person i autorizuar prej tij.

Ky akt u redaktua ne kater kopje gjuhen shqipe me permbajtje te njejte ligjore dhe pasi iu lexua me ze te larte te paraqiturve para meje te cilet duke e gjetur komform vullnetit te tyre te plote dhe te lire ne prezencen time e pranuan aktin dhe e firmosen si me poshte rezulton, une noterja e vertetoi permbajtjen e aktit dhe nenshkrimin e te paraqiturve sipas legjislacionit ne fuqi;

#### PALET KONTRAKTUESE

PALA SHITESE

Z. Albor Mulgeci

Albor Mulgeci

PALA BLERESE

Z. Basri Hakcani

BASRI HAKCANI



NOTERE

ARTA GJ. PIETERNIKAJ



**MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE**  
**TË SHOQËRISË "FaH & Klo" sh.p.k**  
**(NUIS L91408031L)**

Sot, më datë 06.06.2019, ne seline e shoqërisë "FaH & Klo" sh.p.k me adrese ne Tirane, Farke, Sauk, Rruga "Xha Brahimet", Lagjia Sauk i Vjeter, Nd. 21,u mblodh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të kësaj shoqërie:

➤ **Rendi i ditës:** Transferim 100% te kuotave te kapitalit nëpërmjet shitjes nga **Z. Albor Mulgeci**, i biri Abedin-it, lindur me 3.11.1996 ne Bajram Curri, Tropoje, banues në Tiranë, me numër personal J61103021L , ortak i 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë " FaH & Klo"sh.p.k., tek **Z. Basri Mexhit Hakcani**, lindur më 12.09.1985 në Tirane dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr.I50912021E, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I. **Njoftimet:** Në përputhje me ekstraktin nga regjistri tregtar të shoqërisë "FaH & Klo" sh.p.k ortak i saj figuron: **Z. Albor Mulgeci**, me pjesëmarrje në kapital ne përqindje "100,00", ortaku i mësipërm është i vetem, dhe njekohesisht Administratori i shoqërisë.

**II. Pjesëmarrja**

Administratori verifikoi pjesëmarrjen e ortakut në Mbledhje dhe rezultoi se u paraqit për të marrë pjesë në mbledhje ortakut i mëposhtëm: **Z. Albor Mulgeci**, ortak me të drejtë vote në shoqërinë "FaH & Klo" sh.p.k, pjesëmarrje në kapital ne përqindje "100".

**Të drejtat e votës:**

Administratori verifikoi të drejtat e votës së ortakut në përputhje me librin e shoqërisë dhe të dhënat e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, statutit dhe nenit 122 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe rezultoi se ortakut i vetem ka te drejta vote në raport proporcional me zoterimin e 100% te vleres se kapitalit.

Ky vendim është një vendim i cili duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Për sa më sipër, të drejtat e votës në këtë Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme janë si vijon:

1- **Z. Albor Mulgeci**, ortak i vetem i shoqërisë, zoterues i **100%** te te drejtave te votes ne kete mbledhje.

**III. Kryetari**

Me propozim të ortakut **Albor Mulgeci** mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zgjodhi si Kryetar të saj **Z. Albor Mulgeci** me 100% të të drejtave të votës **pro** dhe 0% të të drejtave të votës **kundër**.

**IV. Çelja e diskutimeve**

A. Kryetari çeli diskutimet rreth rendit të ditës.

Në lidhje me këtë çështje ortakut u shpreh:

Ortakut i vetem bie dakort per transferimin, shitjen e 100 % te kapitalit te shoqërisë tek **Z. Basri Mexhit Hakcani**.

Në përfundim të diskutimeve çështja u hodh në votim dhe ortakët votuan si vijon: **Z. Albor Mulgeci pro**.

Për sa më sipër, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve:

**VENDOSI:**

1- Kalimin e kuotave të shoqërisë në masën 100 % me anë të shitjes nga **Albor Mulgeci** tek **Z. Basri Mexhit Hakcani**.

2- Pjesëmarrja në përqindje e ortakëve bëhet 100% , numri në pjesë 1 kuote **Basri Mexhit Hakcani**.

3- Si përfundim, meqënëse të gjitha çështja e rendit të ditës u diskutuan dhe u votuan Kryetari beri te ditur regjistrimin e vendimit ne QKB dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

4- Administrator i shoqërisë pas regjistrimit te vendimit dhe kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit te shoqërisë ne QKB do te jete ortakut i vetem i shoqërisë **Basri Mexhit Hakcani**.

ORTAKU/ET E SHOQËRISË

*Albor Mulgeci*

Vula e Shoqërisë



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NR REP: 1882

DHOMA E NOTERISE TIRANE  
U APLIKUA PULLA 200 LEKE



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, ne Tirane, me date 06.06.2019 (dymije e nentembedhjte), ne Dhomen e Noterise Tirane, para meje noteres se kesaj dhome te quajtures Arta Gj. Pjeternikaj, me seli ne Blv. "Zogu I", Rr. "Dervish Hatixhe", Tirane, u paraqit personalisht shtetasi:

**Z. Albor Abedin Mulgeci**, lindur me 3.11.1996 ne Bajram Curri, Tropoje, banues ne Tirane, me numër personal J61103021L, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, parqitur ne cilesine e ortakut te vetem dhe administratorit te shoqërisë **Shoqëria "FaH & Klo" sh.p.k.**, regjistruar si person juridik me NIPT: L91408031L, me seli ne Tirane, Farke, Sauk, Rruga "Xha Brahimet", Lagjia Sauk i Vjeter, Nd. 21.

Pasi konstatova se eshte person madhor dhe me zotësi te plote juridike per te vepruar, i cili me vullnetin e tij te plote ne pranine time nenshkri duke vendosur emer, mbiemer, firmen e tij dhe vulen per shoqerine ne dokumentin bashkalidhur ketij vertetimi nenshkrimi, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, duke firmosur sot me date 06.06.2019.

Shtetasi i mesiperm deklaroi se e kuptoi dhe eshte dakord me permbajtjen e dokumentit bashkangjitur.

Une noterja pasi konstatova se personi i mesiperm i ka te gjitha aftesite e ligjit, ne baze te Ligjit 110 dt. 20.12.2018 "Per Noterine", me kerkesen e tij vertetova nenshkrimin e vene ne dokumentin e sipercituar, te cilin e firmosi ne prezencen time.

NOTERE

ARTA GJ. PJETËRNIKAJ

*Te dhenat personale mbrohen sipas Ligjit per mbrojtjen e te dhenave personale.*

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20190606155937773  
Data e Rezultatit të Kerkimit: 06.06.2019  
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 3:59:37PM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-599-769'  
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERMIMI 0

ALBOR ABEDIN MULGECI  
FAH & KLO SH.P.K.



*Alisa Iloku*